



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 – 391, t137 dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 29.7.2024, merr këtë:

**V E N D I M**

- I.** Miratohet vendimi për ndarjen e mjeteve financiare “K.H. PRISHTINA”.
- II.** Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.
- III.** Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II. Pjesëmarrja në aktivitetet e organizuara nga Federata e Hendbollit të Kosovës siç janë: Kampionati i Kosovës në Hendboll dhe Kupa e Kosovës në Hendboll, organizimi i ndeshjeve dhe përfaqësimi në Superligën e Hendbollit dhe në garat ndërkombëtare.
- IV.** Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, e K.H. Prishtina
- V.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave në Komunën e Prishtinës.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtate) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
**01-020/08-99487/24 më 31.7.2024**

**KRYESUES I KUVENDIT**  
**Fehmi Kupa**

